



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 29 shtator 2014, në mbledhjen e IX-të (nëntë) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10:05 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z. Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm, z. Agim Veliu Kryetar i Komunës, z. Agim Kikaj, Nënkryetarë i Komunës, drejtorët e Drejtorive komunale, z. Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe i njoftoi këshilltarët e Kuvendit për mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur tri ditë më parë dhe për dy pikat shtesë që KPF i ka rekomanduar Kuvendit për përfshirje në kuadër të rendit të ditës dhe shqyrtimin e tyre në këtë mbledhje, përkatësisht:

- Propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (sipas kërkesës së Salih Tullarit nga fshati Tërnavë), dhe
- Propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (sipas kërkesës së Naip Plakollit nga fshati Letanc)

Gjithashtu kërkoi nga këshilltarët e Kuvendit që të respektojnë Rregulloren e Punës së Kuvendit me theks të veçantë për debatin për rend dite dhe kohëzgjatjen e diskutimeve.

z. Haki Rudari, theksoi, duke u nisur nga ajo që Arsimi është një ndër shtyllat kryesore dhe i cili kërkon një trajtim të veçantë, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, propozoj që në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje të përfshihet pika, përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2014 – 2015, çështje për të cilën mendoj se deri më tani kjo përbërje e Kuvendit nuk ka debatuar fare dhe mendoj se është një lëshim nga vetë këshilltarët, kurse unë kam përcjell shumë seanca të Komunave tjera të cilat kanë debatuar për këtë çështje, madje edhe për dy vitet e mëparshme, andaj kërkesa jonë është që sot të përfshihet në rend dite kjo pikë.

Grupi i këshilltarëve të Lëvizjes Vetëvendosje ka edhe një propozim tjetër ku më 27.08.2014 në kufirin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është vrarë një qytetarë nga Komuna e Podujevës dhe një tjetër është plagosur, ne si subjekt politikë dënojmë fuqishëm këtë ngjarje, andaj në këtë mbledhje të Kuvendit të Komunës kërkojmë nga Kryetari i Komunës apo nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, një informatë zyrtare për këtë incident të ndodhur.

z. Bahri Selimi, theksoi, sot është dita e gjashtë që nxënësit e fshatit Kaçybeg janë jashtë bankave shkollore duke qëndruar në një protestë pakënaqësie që Komuna e Podujevës ka ndërprerë transportin e tyre nga shtëpia deri në shkollë dhe anasjelltas. Mendoj se mos vijimi i tyre në shkollë për gjashtë ditë me radhë është një çështje e ndjeshme, dhe duke qenë në dijeni se arsimi fillorë është obligativ, mendoj se ky Kuvend duhet të zhvilloj një debat dhe të merr një vendim në lidhje me këtë çështje.

Andaj i nderuar Kryesues dhe të nderuar këshilltarë kërkoj mbështetjen tuaj që në këtë seancë të Kuvendit në kuadër të rendit të ditës të përfshihet edhe pika, debat dhe marrja e një vendimi në lidhje me transportin nga shtëpia deri në shkollë dhe anasjelltas për nxënësit e fshatit Kaçybeg të Komunës së Podujevës.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë kemi tri propozime konkrete unë do të hedhë në votim një nga një, mirëpo sa i përket propozimit të parë për debat apo informatë për fillimin e vitit të ri shkollore që kërkoi z. Haki Rudarit, ne nuk jemi kundër kësaj pike por mendoj se është mirë ta lëmë për një mbledhje tjetër ngase nuk kemi material për këtë pikë, mirëpo meqë ke propozuar unë do të hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se me 16 vota për, 16 vota kundër dhe 1 votë të përmbajtur, por në këto raste kur votat janë të barabarta Kryesuesi i Kuvendit ka të drejtën e një vote shtesë e të cilën e dha kundër, nuk kalon propozimi i z. Haki Rudarit që në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje të përfshihet pika, përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkolle 2014 – 2015.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me propozim e dytë të z. Haki Rudarit për një informatë zyrtare për incidentin e ndodhur në kufirin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mendoj se më shumë i përket Komandantit të Stacionit të Policisë në Podujevë që t'i raporton Kuvendit, por meqë patëm propozim, unë e hedh në votim edhe këtë.

Pas votimit u konstatua se me 15 vota për, 18 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur nuk kalon ky propozim që në kuadër të rendit të ditës të përfshihet pika, informatë zyrtare për incidentin e ndodhur në kufirin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kalojmë në propozimin e bërë nga z. Bahri Selimi i cili propozoj një pikë shtesë për këtë rend dite në lidhje me bartjen – transportin e nxënësve të fshatit Kaçybeg nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas.

Pas votimi u konstatua se me 15 vota për, 17 vota kundër dhe 1 votë të përmbajtur nuk kalon ky propozim që në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje të përfshihet pika, debat dhe marrje e një vendimi për transportin e nxënësve të fshatit Kaçybeg nga shtëpitë në shkollë dhe anasjelltas.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk kemi propozime tjera e hedhë në votim rendin e propozuar të ditës me një pikë shtesë sipas rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimit u konstatua se me 19 vota për, 3 vota kundër dhe 12 vota të përmbajtura u miratua rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe dy propozimet e rekomanduara sipas konstatimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa, përkatësisht:

- **Propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (sipas kërkesës së Salih Tullarit nga fshati Tërnavë), dhe**
- **Propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (sipas kërkesës së Naip Plakollit nga fshati Letanc)**

2. Shqyrtimi i Ekstrakteve të procesverbaleve të mbajtura në mbledhjet e Kuvendit më 2 korrik 2014, 18 korrik 2014 dhe 31 korrik 2014

Pas votimit konstatohet se njëzëri miratohet Ekstrakti i procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 2 korrik 2014.

Pas votimit konstatohet se njëzëri miratohet Ekstrakti i procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, mbajtur më 18 korrik 2014.

Pas votimit konstatohet se njëzëri miratohet Ekstrakti i procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 31 korrik 2014.

3. Propozimi i vendimit për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës dhe projektet prioritare për vitet 2015 - 2017

- **Propozimi i Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2015**

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim projektbuxhetin dhe projektet prioritare 2015 - 2017 të Komunës së Podujevës, projektbuxhet i cili përfshin të gjitha fushat dhe lokalitetet e territorit të Komunës së Podujevës. Të gjithë ne jemi në dijeni se ky buxhet nuk është i mjaftueshëm për t'i përmbushur nevojat dhe kërkesat e qytetarëve të Komunës, mirëpo me këtë projektbuxhet në të cilin aktualisht e kemi janë përfshirë kërkesat dhe nevojat më emergjente të Komunës tonë. Ajo çfarë neve na rëndon në buxhetin dhe realizimin e projekteve është barra e cila iu është lënë Komunës së Podujevës nga Qeveria e Republikës së Kosovës për rritjen e pagave prej 25% , gjë e cila i ka shkaktuar Komunës së Podujevës një mungesë të buxhetit për realizimin e shumë projekteve të cilat kanë qenë të planifikuara për tu realizuar.

z. Kadri Avdiu, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës e ka lexuar dhe analizuar me vëmendje këtë projektbuxhet. Për shifrat totale rreth grantit qeveritar dhe të hyrave vetanake nuk kemi çka të diskutojmë, por vërejtja jonë është se në këtë projektbuxhet për vitet 2015 - 2017 ka lëshime dhe ka ndarje të buxhetit në disa pjesë ku janë të shumëfishuara ndërsa disa pjesë tjera janë të paprekura nga ky projektbuxhet, pra vërejtja është se ne miratojmë me shumicë të votave një projektbuxhet në këtë Kuvend ndërsa shpeshherë ndodhë që ky të tjetërsohet dhe të anashkalohet pjesa dërrmuese e këtij projektbuxheti dhe të realizohen projekte të pa miratuara në Kuvend, andaj arsye tjetër që ne nuk mund ta pranojmë një projektbuxhet të tillë kur ne jemi në dijeni se qytetarët e Komunës së Podujevës janë të barabartë të gjithë pa i dalluar fshatrat, meset, largësitë, por duhet të jetë një projektbuxhet i cili i përfshinë të gjitha fshatrat, meset dhe lokalitetet e ndryshme, kurse nuk jemi kudër atyre pjesëve në të cilat çdo vit është një buxhet më i shtuar, kryesisht meseve dhe lokaliteteve nga vie Ekzekutivi i Komunës, kurse pjesët tjera janë të prekur nga një buxhet shumë i vogël, ndërsa kemi edhe pjesë të cilat janë të paprekura fare nga buxheti i Komunës. Pra ne nuk jemi kundër projektbuxhetit të Komunës por jemi kundër ndarjes dhe kundër përshtimit të tij, dhe nuk mund të jemi për këtë projektbuxhet kur kemi të bëjmë me shkelje të të drejtave të qytetarëve ngase të gjithë ne jemi në dijeni se mjetet buxhetore nuk janë të ndonjë individi apo të Ekzekutivit të Komunës, por Ekzekutivi është për t'i menaxhuar ashtu siç duhet këto mjete dhe për të bërë një ndarje të tyre tek qytetarët si dhe për të mos bërë padrejtësi të një pjesë e qytetarëve. U përmend problemi i fshatit Kaçybeg, për mos vijimin e nxënësve në shkollë, aq më shumë kur kjo ndodh në shekullin e XXI, prandaj konsideroj se deri te një gjendje e këtillë vihet kur nuk projektohet dhe nuk planifikohet mirë projektbuxheti e natyrisht se duhet të ballafaqohemi me këso lloj problemesh, pra këto janë ato vërejtjet tona dhe ato lëshimet që ne nuk mund të votojmë për. Vlen të përmendet ndërtimi i zyrës së vendit në vitin 2016 në fshatin Lluzhan, fshat i cili ka qenë një qendër në të kaluarën e lëre më sot, dhe tani ndërtimi i asaj zyre bartet në fshatin Gllamnik, jo që jemi kundër për këtë bartje por mendojmë se më e rëndësishme është të ndërtohet në fshatin Lluzhan sesa në fshatin Gllamnik ngase ky i fundit është më afër Podujevës kurse Lluzhani përfshin më shumë fshatra përreth dhe do të kishte rëndësi më të madhe, dhe mendojmë se janë qëllime të cilat nuk i bëjnë mirë as Ekzekutivit të Komunës e as qytetarëve, dhe është e papranueshme dhe e pa tolerueshme të lihet një mes pa zyrë vendi që 15 vite pas luftës kur dihet se në kohërat më të mjerueshme ajo qendër ka pasur zyrë të vendit, madje shumë të zhvilluar. Pra ne nuk mund të mbështetim këtë projektbuxhet me këto defekte të theksuara dhe me bartje të mjeteve me qëllime të caktuara, ngase konsiderojmë se këto mjete që janë duhet të menaxhohen ashtu si duhet dhe të përfshihen mese të tëra.

Vërejtja se për fshatin Dyz janë gjetur mjete në shumë 35,000.00 € për ndërtimin e kanalizimit, gjë që më erdhi mirë ngase ne kemi bërë vërejtje në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe tani po e shoh se ajo vërejtje është marrë parasysh, kur jemi në dijeni se në atë fshatë nuk ka pasur investime nga ana e Komunës që 8 vite dhe nuk janë paraparë as për tri vitet e ardhshme, ndërsa pyes pse ne gjithmonë duhet të bëjmë vërejtje e pastaj Ekzekutivi të shikon mundësit siç është ky rast ku para tri dite nuk pati mundësi ndërsa sot u gjend kjo mundësi. Pra edhe një herë e them se ka mundësi me rishikuar dhe me ndryshuar këtë projektbuxhet dhe me nda në mënyrë lineare ku do të përfshiheshin të gjitha fshatrat dhe gjitha meset, kurse me sa unë shohë në këtë

projektbuxhet mjetet kryesore i kanë marr 12-13 fshatra kurse fshatrat tjerë janë të pa përfshira në këtë projektbuxhet

z. Haki Rudari, theksoi, paraprakisht dua të ndërlihem me pjesën hyrëse të kësaj mbledhjeje, kolegë këshilltarë nga subjekti politikë LDK, të votoni kundër pse sot të debatojmë që nxënësit nuk janë të pajisur me libra, pastaj pse sot të debatojmë që nxënësit nuk janë regjistruar në shkolla dhe bredhin rrugëve, dhe të votoni kundër që të debatojmë pse ne mësimdhënësit në ekskursion shkojmë me 70-75 €, ndërsa nxënësit e shkollave të mesme paguajnë deri në 120 €, mendoj se nuk është në rregull, dhe nuk është aspak politike, mirëpo sido që të jetë secili e ka mendimin e vet dhe votën e vet.

Për Grupin e këshilltarëve të Lëvizjes Vetëvendosje buxheti vjetor paraqet një dokument të rëndësishëm për Komunën e Podujevës ku mënyra e planifikimit, menaxhimit, realizimit dhe shpërndarjes së tij ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve të Komunës tonë dhe në zhvillimin e tërësishëm.

Ne e kemi shqyrtuar dhe analizuar me kujdes të veçantë projektbuxhetin e Komunës për vitet 2015 – 2017, dhe pas kësaj konstatojmë se projektimet buxhetore nuk shprehin nevojat dhe kërkesat e qytetarëve dhe nuk shfrytëzohet pozicioni lokal për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ngase projektbuxheti është hartuar dhe projektuar në mënyrë jo të mirë, me pjesëmarrje jo të mirë të qytetarëve, planifikimi dhe shpërndarja e buxhetit nuk i plotëson nevojat dhe kërkesat e qytetarëve në zona të caktuara por kryesisht buxheti orientohet në zona ku jetojnë apo nga vijnë zyrtarë të lart të Komunës gjegjësisht partisë në pushtet. Prandaj për ne është shumë me rëndësi që buxheti, projektet dhe shpërndarja e tyre të bëhet aty ku është e nevojshme, në interes të qytetarëve dhe pa anime politike. Po ashtu ky dokument edhe në aspektin teknik nuk ofron sqarime të nevojshme si dhe për përfundimin e projekteve të nevojshme më shumë thuhet, projekt në vazhdim, dhe se projektbuxheti për vitin 2015 kryesisht përqendrohet për asfalt dhe kanalizim që në parim e përkrahim, por që lihen anash apo nuk preken fare çështje të rëndësishme si; kujdesi social, shëndetësia, kultura, sporti, bujqësia, arsimi, mjedisi jetësorë dhe turizmi. Gjithashtu për ne dhe shumicën e qytetarëve është e papranueshme se si Ekzekutivi i Komunës nuk parasheh asnjë shumë buxhetore për ujin e pijshëm, gjë e cila është mjaft serioze dhe që gjatë fushatës zgjedhore është premtuar. Pra të gjitha këto që u thanë mund të përfundojmë se Komuna e Podujevës dhe qytetarët e saj e meritojnë një buxhet më ndryshe nga ky i cili na është paraqitur nga qeverisja aktuale dhe se në hartimit të tij do të duhej të kishte një përfshirje më të madhe të qytetarët si dhe përfaqësuesve të fshatrave.

Në vazhdim do ti lexoj disa vërejtje të cilat ne i kemi gjetur në Drejtori të ndryshme;

Drejtoria e Planifikimi Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, nga 1 deri në 7 kemi vetëm vazhdim të projekteve, gjë e cila nuk është e detajuar mirë, pastaj kemi projekte të papërfunduara në shumë 132,203.00 € të cilat nuk specifikohen gjë e cila mbetet e pa arsyeshme se ku dhe si do të shpenzohen ato mjete, ne si Grup e kemi vizituar fshatin Dumosh ku për 15 vite me radhë nuk është bërë pothuajse asnjë investim, dhe se rrugët dhe infrastrukturat tjera janë në gjendje të mjerueshme, dhe mendojmë se nuk ka fshat që është prekur nga investimet më pak se fshati Dumosh.

Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, kemi vërejtur disa investime të cilat mendojmë se nuk janë shumë të arsyeshme, shembull, rregullimi dhe rrethimi i platos së tregut të qytetit me rreth 30,000.00 €, këtë e them ngase është ndërtuar njëherë, pastaj kemi rreth 20,000.00 € për mirëmbajtje dhe infrastrukturë të varrezave gjë

për të cilën në parim jemi për këtë por është mirë të dihet se ku dhe si ndërtohet apo mirëmbahet ajo infrastrukturë dhe në cilat varreza, e cekë këtë ngase jemi dëshmitarë ku shumë qytetarë në mënyrë vullnetare kërkojnë mjete buxhetore nga donatorë të ndryshëm për mirëmbajtje të varrezave, dhe se në këtë projektbuxhet nuk figurojnë fare varrezat e Dëshmorëve.

Drejtoria e Arsimit, për zgjerim dhe renovim të objekteve shkollore ka planifikuar 195,050.00 €, ku nga të hyrat vetanake nuk parashihet asnjë shumë, ndërsa ne jemi në dijeni se problemet në Arsim janë të shumta dhe se ka nevojë për investime të shumta.

Drejtoria e Administratës, inventarizimi i objektit të ri të Administratës në shumë 75,000.00 €, mendoj se është një shumë e madhe në krahasim me buxhetin total të Komunës.

Edhe pse jemi opozitë, ne Lëvizja Vetëvendosje në vazhdim do t'i japim disa propozime të cilat janë drejtpërdrejt në interes të qytetarëve dhe që nuk janë aspak politike, si vijon;

1-Propozojmë ndërtimin e një shkolle në fshatin Kaçybeg, ku paraqitet nevojë shumë emergjente, ne jemi në dijeni se Ministria përkatëse është përgjegjëse për ndërtimin e shkollave mirëpo është mirë që Komuna ta ketë në projekte prioritare ngase ndryshe Ministria nuk mund të investoj.

2-Mbështetje financiare, bursa për studentë për familjet e Dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës, pastaj sigurim e një shujte ditore për të gjithë nxënësit deri në klasën e pestë, gjë e cila do të kishte një efekt zingjirorë shumë pozitivë, ku kemi rreth nëntë mijë nxënës nga klasa e parë deri në klasën e pestë dhe nëse llogarisim një shumë rreth 0.30 cent do ti bie një shumë rreth 2700.00 € deri në 3000.00 € e që nuk do të ishte ndonjë shumë e papërbalueshme por do të ishte në interes shumë të madh të nxënësve dhe nuk do të mund të themi se këtu po investohet vetëm në aspektin politik.

3-Krijimin e parkingjeve ku do të ndikonte shumë në rregullimin e komunikacionit.

4-Urgjentisht të filloj pajisja e shkollave me mjete si laborator, biblioteka, salla të leximit ku do të kishte një rëndësi të veçantë ngase kur dihet se në qoftë se nxënësit kanë një sallë të leximit nuk do të dalin të bredhin rrugëve.

5-Propozojmë ndarjen e një shume të caktuar për gjetjen e burimeve alternative për ujin e pijshëm, gjë për të cilën kërkesa e qytetarëve është e madhe, e që nga viti 2012 deri në 2016 nuk parashihet asnjë buxhet në këtë drejtim.

6-Rritje e subvencioneve për bujqit, por ndarja të mos bëhet në baza politike.

7-Mbështetje klubeve lokale sportive, gjë e cila do të ishte në interes të rinisë.

8-Përkrahje Shoqatave dhe Organizatave të ndryshme të cilat merren me personat me nevoja të veçanta, përkrahja e Shoqatave të dala nga lufta dhe përkrahja e Shoqatave të ish të burgosurve politik duke pasur parasysh kontributin e tyre shumë të madh.

9-Gjelbërimin e oborreve të shkollave dhe të institucioneve publike, e që në këtë drejtim çalojmë shumë.

10-Kujdes i veçantë për mbrojtjen e ambientin jetësorë.

Prandaj i nderuar Ekzekutiv i Komunës, këto propozime të Grupit të këshilltarëve të Lëvizjes Vetëvendosje janë pa dallime politike dhe janë në interes të qytetarëve, andaj dëshirojmë që këto kërkesa të merren parasysh dhe të fillohet me implementimin e tyre sa më shpejtë gjë që edhe ne si opozitë jemi në gjendje të ndihmojmë në këtë drejtim.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, është shumë gjë e keqe që kjo seancë filloi me censurë nga ana e Kryesuesit të Kuvendit, e them këtë ngase jemi thirrur për të debatuar për projektbuxhetin dhe për t'i miratuar projektet prioritare për qytetarët. Pa dashur të debatoj për projektet që i përmendën parafolësit, dua t'ia përkujtoj z. Fidan Rekaliut se nuk jemi në fazën emergjente sepse ajo fazë ka përfunduar në vitin 2005 me një vendim të Kryetarit të Komunës në Kuvendin e Komunës, ndërsa z. Rekaliu në diskutimin e tij e tha se ky projektbuxhet i plotëson emergjencat, ndërsa unë them se tani jemi në vitin 2014 dhe nuk mund të bëhet fjalë më për emergjenca ngase i bie që Komuna e Podujevës dhe pikërisht subjekti që udhëheq që 15 vite me këtë Komunë nuk paska bërë asgjë.

Lidhur me rritjen e pagave, unë mendoj se duhet t'i gëzohemi të gjithë, jam në dijeni se është barrë për drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave por konsideroj se me një qeverisje të mirë do të ishte tejkaluar ky problem duke përdorur mjetet nga të hyrat vetanake, për të cilat mendoj se është shumë gjë e keqe që ato mjete financiare ridestinohehen në disa lokacione kryesisht nga vijnë drejtorët e Drejtorive si Bradash, Dumnicë, Bajqinë, Dobratin, kurse për kundër kësaj borgjelinjë të mëdhenj të cilët e vështirësojnë qeverisjen e mirë në këtë Komunë janë po nga këto fshatra, në Komitet për Politikë dhe Financa kam kërkuar nga drejtori përkatës që të nxjerr një listë me borgjelinjë të mëdhenj që kanë për tatimin në pronë, listë e cila nuk është sjell as në këtë mbledhje, mirëpo mendoj se ky problem do të tejkalohet. Drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë z. Abaz Llugaliun pa një kërkesë të gjatë që kam bërë më ka sjellë listën e pronave publike dhe shfrytëzuesve të atyre pronave sipas së cilës janë afër 150 prona të ndryshme ku nga to në qoftë se vetën nga 1 € në muaj do të inkasonte Komuna i bie rreth 200 € në muaj, ndërsa nëse i kalkulojmë me shumën që ata duhet ta paguajnë do të dilte një shumë e mjaftueshme, prandaj mendoj se nuk është qeverisje e mirë kjo.

Projektbuxhetin e paraqitur nga Ekzekutivi i Komunës mendoj se edhe ne si opozitë do të donim ta miratonim, mirëpo më së miri do të ishte ta arsyetojnë drejtorët e Drejtorive se a është projektbuxhet i planifikuar dhe i ndarë mirë apo jo, gjë të cilën tri ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk kanë mundur ta arsyetojnë disa nga drejtorët e Drejtorive. Nuk dua të debatoj jashtë rendit të ditës mirëpo i nderuari Kryesues i Kuvendit as ty nuk të është ofruar as një raport nga Drejtoritë përkatëse dhe nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi që nëntë muaj të kësaj legjislature, kurse plani që na është sjellë nga ky Këshill është e paraparë që dy herë në vit të bëhet raport para Kuvendit të Komunës, e them këtë ngase është dashur të bëhet një raport për Sigurinë në Bashkësi dhe është dashur të kemi një raport nga Drejtoria e Arsimit për gjendjen e Arsimit dhe të jepet një arsye pse nuk bëhet shpërndarja e teksteve shkollare dhe pse rrinë ato tekste nëpër stoqe dhe podrume ndërsa thuhet se nuk i ka sjellë ende Ministria e Arsimit, pse nuk është filluar procesi mësimorë me kohë në disa shkolla, dhe pse nuk është kompletuar kuadri i mësimdhënësve në shumicën e shkollave, kështu që do të ishte shumë e nevojshme të bëhej një debat, por që nuk kaloj me vota për tu përfshirë në rend dite për këtë mbledhje është shkak i një qeverisje të keqe duke përfshirë edhe Kryesuesin e Kuvendit i cili për të plotësuar një dëshirë të dikujt tjetër nuk e futë në rend dite një pikë që është shumë e nevojshme të debatohet për të gjithë e në veçanti për fëmijët-nxënësit të cilët jetojnë dhe vijnë shkollimin në Komunën e Podujevës.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, nënvizoi, parafolësi e tha se Kryesuesi e filloj këtë mbledhje me censurë, ndërsa unë them, në qoftë se ju mendoni se respektimi i Rregullores së Punës së Kuvendit është censurë, atëherë le të mbetet mendim i juaji.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, tema të cilën jemi duke trajtuar ndoshta është tema më kruciale për një vit kalendarik për Kuvendin e Komunës. Nuk dua të lëshohem shumë në detaje të këtij projektbuxheti, mirëpo dua që të tërheq vërejtjen në dy apo tri gjëra të cilat sipas meje janë më të rëndësishmet. Konsideroj se ky projektbuxhet i planifikuar është më shumë shpenzues, ndërsa ka ndikim të vogël në rritjen e normës së zhvillimit ekonomik, dhe e vërteta është që ky projektbuxhet është i vogël por nuk është për fajin tonë, ndërsa shpërndarja e këtij projektbuxheti nuk është shumë premtuese. Unë do ti drejtohem dy drejtorëve të dy Drejtorive, përkatësisht drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, ku për fat të mirë këto dy Drejtori kanë rritje të buxheti për këto vite, mirëpo pyes se a ka kalkuluar DBPZHR efektet e këtij buxheti mbi 450,000.00 € dhe rindarjes së tij në sektor të kësaj Drejtorie, shembull, 110,000.00 € subvencione për mbjellje pranverore dhe vjeshtore cilat janë efektet dhe sa gjenerohen të hyra dhe sa gjenerohen vende pune, gjithashtu në pemëtari e që konsideroj se është dashur t'i ipet shumë më shumë prioritet dhe të ndahen shumë më shumë mjete, e them këtë ngase mendoj se nuk është e nevojshme të jesh shumë i ditur dhe i arsimuar por përvojat e të tjerëve bëjnë të ditur që cilat fusha dhe cilat pjesë janë ato të cilat janë profitabile që gjenerojnë një të ardhme dhe vende të punës e për të cilat kemi shembuj në regjion, ku Komuna me madhësinë e gjysmës së Komunës tonë brenda vitit vetëm prej pemëtarisë së imët eksporton mallra në vlerë prej 100 milion \$, ndërsa ku jemi ne në këtë drejtim kur kemi potencial dhe në nivel vendi kemi dyfishin e potencialit të kësaj lëmie sepse për kokë banori kemi dyfishin e sipërfaqes së punueshme në nivel vendi se sa regjionet tjera, mirëpo si duket e keqja është që këtu nuk janë identifikuar potencialet tona, mundësit, objektivat dhe synimet tona se ku dëshirojmë arrijmë, andaj e thash se ky buxhet është ndarë si më shumë buxhet shpenzues, dhe ndoshta paksa del e vrazhdë, mirëpo mendoj se kjo është bërë ndoshta për t'i kënaqur votuesit dhe meset e caktuara, mirëpo njerëzit kanë më shumë nevojë për t'i gjeneruar të ardhurat dhe për të jetuar dhe për të siguruar një vend pune.

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, më vie mirë që janë planifikuar edhe mundësit e zonave për qëllime zhvillimore, mirëpo më duket se ndoshta jemi paksa të vonshëm në këtë drejtim ngase shumë Komuna këto gjëra veç i kanë kryer, kurse çështja tjetër është se duhet të jeni në dijeni që Komuna e Podujevës ka dy fusha të cilat japin mundësi apo kanë potencial për zhvillim, ku përveç asaj që e përmenda më parë për Bujqësinë, është edhe turizmi rural, turizmi malorë e të tjera, do të thotë përveç Orllanit të cilin e kemi gjetur ashtu siç është, ne ende nuk kemi identifikuar se në cilat pjesë dhe cilat zona janë atraktive që mund të bëhet turizëm, e që mendoj se kemi shumë zona atraktive ku në qoftë se Komunat tjera do të kishin zona të tilla me siguri se do të merreshin me eksploatim të tyre dhe me siguri se do të kishin përfitime.

Ndërsa zonat tjera si ato komerciale, industriale e të tjera janë të domosdoshme, e them këtë ngase jemi dëshmitarë që në Kuvend në shumicën e mbledhjeve na duhet të miratojmë vendime për destinim të tokës bujqësore të klasës së parë, në tokë ndërtimore, kjo bëhet krejt për fajin tonë ngase nuk janë të përcaktuara zonat përkatëse.

z. Naim Çunaku, theksoi, tani kur para vetës kemi projektbuxhetin dhe projektet prioritare të Komunës së Podujevës për vitet 2015 – 2017, pa dashur t'i përsërisë të gjitha ato vërejtje që i thanë parafolësit unë do të ndalem në disa vërejtje për të cilat mendoj se nuk duhet anashkaluar pa i përmendur. Vetë fakti që ne kemi kundërshtuar Kornizën Afatmesme Buxhetore dokument ky i cili i paraprinë projektbuxhetit që tani kemi para vetës, e që edhe atëherë nuk kemi përkrahur ndarjen e projekteve prioritare për mese të caktuara, ndërsa tani me këtë projektbuxhet shihet se projektet prioritare kanë shkuar në mese të caktuara, ku pas analizës që kam nxjerrë, projektet të cilat janë paraparë për mese të caktuara dhe që mua më dolën vetëm 13 fshatra që do të investohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, ndërsa nga Drejtoria e Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit kemi vetëm 15 fshatra që do të investohet, ndërsa shtrohet pyetja se ku mbesin meset tjera, dhe për këtë do të marr një shembull ku në fshatin Obranqë kemi 430,000.00 € të planifikuara për investime, në fshatin Dumnicë kemi mbi 400,000.00 €, në fshatin Gllamnik mbi 200,000.00 €, është mirë që kemi mundësi të ndajmë shuma të tilla, por nuk është mirë që kemi mese të caktuara që nuk janë prekur fare nga planifikimet për investime ndërsa një pjesë e lokaliteteve të cilat janë përfshirë vetëm sa për të zënë vendin janë me shifra 20,000.00 € e më pak. Mirëpo kur kemi të bëjmë me ndarjen e këtyre mjeteve, kur është filluar viti kalendarik neve nuk na është ofruar plani i punës nga Drejtoritë e caktuara, e që kur nuk ke planifikim të mirë me siguri se vie edhe faza e ridestinimeve madje edhe duke tejkaluar 30% e ridestinimeve të mjeteve buxhetore me qëllim të adaptimit të tyre në mese të caktuara. Mirëpo për të mos e zgjatur shumë unë kam disa propozime konkrete për të cilat në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi bërë vërejtje për këto projekte prioritare, ndërsa na është thënë se për bazë janë duke u marrë sepse meset e caktuara po hartojnë projekte dhe ato projekte nuk kemi si mos ti marrim parasysht kurse meset tjera nuk kanë bërë projekte, ndërsa kur kemi debatuar për Kornizën Afatmesme Buxhetore si dhe shumë hera tjera, e kemi thënë, pikërisht unë, decidimisht kam propozuar që Kuvendi i Komunës për vitin buxhetorë të ndan një pjesë të fondit për hartimin e projekteve për të gjithë territorin e Komunës, ndërsa po ta kishim planin e punës dhe po të kishim një vijë buxhetore të ndarë për hartimin e projekteve, për mese dhe lokalitete të cilat kanë nevojë për investime, ne sigurisht që do të bënim një ndarje më të drejtë të atyre nevojave të qytetarëve të Komunës së Podujevës, pra pas gjithë kësaj që e thash ne as sot nuk kemi të ndarë asnjë shumë të mjeteve buxhetore për hartimin e projekteve, por thirren në atë që qytetarët vetë duhet t'i hartojnë projekte, ndërsa unë pyes, deri kur dhe pse vetëm ne i detyrojmë qytetarët që vetë të hartojnë projekte. Rrallë herë kam folur për lokalitetin nga unë vij, por kësaj radhe më duhet të ndalem ngase fshati Llugë ka mbi 2000 banorë dhe mbi 200 shtëpi, oborri i shkollës së këtij fshati është në gjendje të mjerueshme dhe mund të them se është një prej shkollave të fundit në territorin e Komunës së Podujevës që nuk ka fushë të sportit gjë, të cilën e kam kërkuar disa herë, ndërsa inventari i asaj shkolle është që nga vitet e 80-ta kur edhe është ndërtuar ajo shkollë. Gjithashtu u përmenden mjete të ndara për ndërtim të trotuareve, andaj kërkoj që mundësisht të orientohet ndërtimi i trotuarit në fshatin Lluzhan ku është e ndërtuar shkolla e këtij fshati dhe në fshatin Llugë, kërkoja ngase është i përcaktuar vetëm si trotuar por që nuk është i përcaktuar vendi.

Në tri vitet e ardhshme i kemi të ndara 60,000.00 € për shtrimin e tri rrugëve të lagjeve të fshatit Llugë, shumë e cila mendoj se nuk është e mjaftueshme, andaj kërkoj që kjo shifër

të rritet apo të paktën të dyfishohet. Çështje tjetër që kam për të përmendur është rruga Penuh – Buricë, e që nxënësit e fshatit Penuh për të arritur në shkollën e fshatit Buricë iu duhet të përshkojnë një rrugë prej tri km. ndërsa është një alternativ tjetër ku nëse shtrohet një rrugë me gjatësi rreth 500 metra do t'ua lehtësonte shumë rrugëtimin atyre nxënësve dhe do t'ua largonin rrezikun ngase atyre iu duhet të kalojnë nëpër rrugën magjistrale, gjë të cilën e kam kërkuar disa herë që të futet në projekte prioritare.

Ndërsa sa i përket zyrës së vendit që e përmendi z. Kadri Avdiu, unë them se sa është planifikimi i mirë për zyret e vendit në territorin e Komunës tonë tregon fakti ku ne e kemi të ndërtuara zyret e vendit në fshatrat Herticë, Pollatë e të cila nuk janë funksionalizuar asnjëherë, ndërsa të ketë zyret e vendit duke filluar nga fshati Lupç e deri në Pollatë dhe të mos ketë në fshatin Lluzhan mendoj se kjo nuk do shumë koment.

z. Hasan Softolli, theksoi, e përkrahi këtë projektbuxhet dhe projektet prioritare të Komunës së Podujevës për vitet 2015 – 2017 dhe konsideroj se ky projektbuxhet i mundëson Komunës dhe Drejtorive përkatëse që në kohë t'i kryejn punët dhe detyrat prioritare dhe t'i realizojnë objektivat e përcaktuara më herët.

Në këtë projektbuxhet vërehet se Komuna e Podujevës në vazhdimësi bën projekte për konsolidim të aktiviteteve dhe punëve si brenda Drejtorive komunale edhe qendrave operative ashtu edhe punëve në terren. Po ashtu parashihen dhe bëhen përpjekje që me këto kapacitete jo të mjaftueshme financiare, të bëhen zgjerime dhe përmirësime në jetën shoqërore dhe ekonomike. Gjithashtu parashihen planifikime për investime në zgjerim të mëtutjeshëm në mjekësi si; objektin e maternitetit, objektin e hemodializës i cili është shumë me rëndësi, blerje të rentgeneve, ngritje të ambulancave, e të tjera. Sa i përket zhvillimit ekonomik vërehet se Ekzekutivi i Komunës ka planifikuar ngritjen e inkubatorit të biznesit, promovimit, participimeve e shumë planifikime tjera të nevojshme, ndërsa sa i përket Bujqësisë parashihen ngritje dhe zgjerim në fushat e blegtorisë, bletarisë, perimekulturës, pemëtarisë e të tjera. Në fushën e kulturës rinisë dhe sportit po ashtu vërehet planifikim në ngritjen e qendrës së kulturës, në fushën e Urbanizmit fushë e cila është lëmi e cila kërkon në vazhdimësi projekte dhe financime të mëdha ku parashihen rritje të investimeve të rrjetit të kanalizimeve, asfaltimeve, ndërtim të kolektorëve të ujërave të zeza të cilët janë të kushtueshëm, pastaj kemi rritje të investimeve për ndërtime të trotuareve, ndriçime dhe investime tjera të ngjashme. Duke mos i përmendur planifikimet dhe projektet tjera të Drejtorive tjera, konsideroj se në përgjithësi ky projektbuxhet shihet se ka një strukturë të mirë sa i përket destinimit dhe shfrytëzimit financiarë.

Andaj në qoftë se e analizojmë në detaje këtë projektbuxhet nuk mund të thuhet se ka anime politike por mund të thuhet se është i shpërndarë dhe gjithëpërfshirës sa i përket meseve dhe lokaliteteve të ndryshme ku ne jetojmë,

Është e vërtetë se ky projektbuxhet ka limite financiare gjë që nuk na mundëson të realizojmë të gjitha nevojat dhe kërkesat e qytetarëve, mirëpo pavarësisht shkurtimeve dhe intervenime të ndryshme buxhetore, konsideroj se projektbuxheti dhe projektet prioritare për vitet 2015 – 2017 të Komunës së Podujevës është planifikim i mirë nga ana e Ekzekutivit të Komunës.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ne sot para vetës kemi një dokument shumë të rëndësishëm, përkatësisht propozim buxhetin dhe projektet prioritare për vitet 2015 – 2017. Propozim buxheti për vitin 2015 është 18,306,493.00 €, e që nga ky buxhet 11,000,000.00 € apo 60% e buxhetit total, janë të destinuara për pagat e 1976 të

punësuarve në Arsim, Shëndetësi dhe Administratë komunale bazuar në koeficientet e caktuara me vendime përkatëse. Mandej 5.8% nga buxheti total janë të parapara për mallra dhe shërbime, 1.8% për shpenzime komunale, 3.8% janë të parapara për subvencione dhe transfere, ndërsa 28.5% apo 5,228,275.00 € e buxheti total janë të parapara për investime kapitale, shumë kjo ku kryesisht ne sot jemi duke debatuar e që ka të bëjë me projektet prioritare, në krahasim me vitin e kaluar është shumë më e vogël për shkak të rritjes së pagave prej 25%. Se a mjafton ky buxhet për të realizuar të gjitha kërkesat dhe nevojat e qytetarëve, sigurisht se nuk mjafton, me këtë buxhet janë të parapara 81 projekte, projekte të cilat i keni në materialin bazë, dhe atë, 28 projekte janë kryesisht infrastrukturë rrugore, 34 projekte janë në rrjetin e kanalizimit, ujësjellësit dhe trotuare, 4 projekte të parapara për zhvillimin ekonomik, 3 projekte për administratë, 4 projekte në bujqësi, 6 projekte në shëndetësi, 1 projekt në arsim dhe 1 projekt në kulturë. Propozimi i këtyre projekteve është bërë duke u bazuar në debatet me qytetarë, strategjinë e zhvillimit ekonomik lokal të Komunës së Podujevës si dhe në kornizën buxhetore për vitet 2014 – 2016. Konsideroj se të gjitha këto projekte janë të arsyeshme dhe si të tilla propozoj që të miratohen nga ju këshilltarë të nderuar.

Gjithashtu konsideroj se ne duhet t'i përkrahim edhe projektet tjera të cilat mund të realizohen nëpërmes donatorëve të ndryshëm si dhe nga Ministritë përkatëse të cilat kanë fonde të ndara për Komunat, e që në vitet e fundit mungon përkrahja financiare nga niveli qendrorë. Deri sa Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2014, për investime kapitale ka një buxhet rreth 25 milion euro, investimet për neve si Komunë janë vetëm simbolike ngase Komuna e Podujevës si për nga numri i banorëve ashtu edhe për nga numri i nxënësve bënë pjesë me rreth 5% të popullsisë së Kosovës apo nxënësve të Kosovës, e që në këtë rast nëse ndahet ajo shumë prej 25 milion euro e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë nëpër Komuna në mënyrë të barabartë neve do të na takonin së paku 1 milion euro për çdo vit për investime në këtë fushë. Gjithashtu, nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, edhe pse ne për çdo vit i bëjmë kërkesa për rregullim të hapësirave mjedisore, nuk kemi pasur kurrfarë ndihme edhe përkundër asaj që kjo Ministri për vitin 2013 ka pasur një buxhet të konsiderueshëm që i ka shkuar në suficit, mirëpo shpresoj që kjo qasje duhet të ndryshohet në të ardhmen. Pra edhe një herë ju lus të nderuar këshilltarë që njëzëri të përkrahet ky projektbuxhet dhe këto projekte prioritare për vitet 2015 – 2017.

Para se të përfundoj diskutimin tim, disa diskutime nga kjo mbledhje më nxitën t'i them vetëm disa shembuj rreth menaxhimit të parasë publike në Komunën e Podujevës.

Asociacioni i Komunave të Kosovës i ka publikuar indikatorët e performancave të Komunave të Kosovës për vitet 2012 dhe 2013, nga burimet e audituara, pasqyrat vjetore financiare dhe të dhënat nga Komunat në disa fusha siç janë; të hyrat vetanake, kostoja e reprezentacionit, inspeksioni, rrugët, arsimi dhe shëndetësia, nëse i marrim dhe i analizojmë nga ky material se, sa Komunat kanë shpenzuar buxhet për 1 km. asfalt, do të vërehet se Komuna e Podujevës bënë pjesë në tri Komunat të cilat kanë shpenzuar më së paku buxhet për 1 km. asfalt apo 38,856.00 €, kurse Komuna e cila ka shpenzuar më së shumti buxhet për 1 km. asfalt kapë shifrën 163,903.00 €, e që i bie 4 fishi i shumës së shpenzuar nga Komuna e Podujevës. Sa i përket shpenzimeve të reprezentacionit, Komuna e Podujevës është Komuna e cila ka shpenzuar më së paku ku për vitin 2012 janë 9,126.00 €, ndërsa për vitin 2013 janë 4,126.00 €, të dhëna të cilat janë marrë nga SIMFK apo kodi 14310 – dreka zyrtare, kurse një Komunë tjetër e përafërt me numrin e

banorëve të Komunës tonë, për reprezentacion ka shpenzuar në vitin 2012 një shumë prej 125,359.00 €, kurse në vitin 2013 ka shpenzuar për reprezentacion shumë 168,582.00 €. Pra me këtë rast vlen të theksohet se në Komunën e Podujevës, përveç Kryetarit të Komunës i cili ka të drejtë ligjore të shpenzoj reprezentacion, asnjë zyrtar tjetër në Komunën e Podujevës nuk shpenzon mjete buxhetore për reprezentacion.

Në Komunën e Podujevës kanë mbetur edhe disa rrugë të lagjeve dhe disa rrugë lokale për të cilat mendoj se gjatë këtyre tri viteve do t'i përfundojnë, këtë e them duke marrë për bazë që në mandatin e kaluar Komuna e Podujevës ka shtruar mbi 200 km. asfalt, kurse nëse e analizojmë se si është shpërndarë ky projektbuxhet për të cilin jemi duke e debatuar, u përmend fshati Dyz, ndokush mund të mos jetë në dijeni por në vitin 2006 është asfaltuar rruga 6 km. deri në fshatin Dyz me një shumë rreth 500,000.00 €, por edhe vitin e kaluar Ministria e Infrastrukturës ka investuar rreth 600,000.00 € në atë fshat që i bie gjithsejtë mbi 1 milion euro, kështu që jemi në dijeni se kanë mbetur edhe disa rrugë dhe besoj se brenda dy apo tri viteve do të përfundohen edhe ato.

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Mjedisit, theksoi, do të përpiqem t'i jap disa sqarime, me qëllim që të mos mbesin si dilema disa çështje që paraqitësit i paraqiten si vërejtje, dhe disa përgjigje rreth disa pyetjeve që u parashtuan. Lidhur me atë që z. Haki Rudari në diskutimin e tij e tha se në fshatin Dumosh nuk është investuar fare që 15 vite, unë them se jemi dëshmitarë që në vitin 2011 në fshatin Dumosh janë investuar mbi 6 km. kanalizim, ndërsa rreth kërkesës që u paraqit për investime në burime alternative të ujit të pijes, përgjigja është se duhet pasur parasysh se kjo rregullohet në bashkëpunim me kompaninë e ujësjellësit, gjë për të cilën nuk dua të lëshohem rreth kompetencave të Komunës dhe kompanive, mirëpo krejt çka mund të them është se kompanitë e ujësjellësit nuk shpenzojnë në rrjete të zgjerimit të ujësjellësit ngase kompania përkatëse tani për tani nuk ka kapacitete furnizuese për Komunën tonë dhe se asetet tona do të kalonin nga ato komunale në asete të kompanisë. U përmend edhe platoja e tregut të qytetit, e që kjo çështje ka të bëjë me tregtarët sezonal dhe tregtarët ditorë në tregun e gjelbër, pra të gjithë ne kemi rastin të shohim çdo ditë tregtarë të cilët shesin nëpër rrugë, prandaj kemi menduar që të rregullojmë një pozicion në atë lokacion për ata tregtarë. Lidhur me atë që z. Naim Çunaku e tha se shtrirja territoriale e planifikimeve për të investuar Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit është vetëm në 13 fshatra, nuk qëndron kjo ngase kemi minimum dyfishin e fshatrave të cilat do të preken nga investimet e Komunës, përkatësisht DSHPMSH, mirëpo në shumë vende kemi projekte të cilat janë të përgjithësuara, shembull, planifikimet për trotuare, kemi disa vende që do të shtrohen trotuare, afër shkollave të ndryshme, afër rrugëve magjistrale e që do të mund të përfshihen së paku 5 – 6 fshatra, apo kemi edhe projekte tjera të përgjithshme si, rregullimi apo mirëmbajtja e lumenjve që mund të përfshihen po ashtu disa fshatra, mandej kemi projekte për ndërtimin e garazheve dhe rregullimi i shërbimit të zjarrfikësve, për të cilin nuk foli askush se është planifikim apo investim i qëlluar dhe duhet të miratohet.

Për të gjithë drejtorët e Drejtorive ka qenë e dhimbshme zvogëlimi i buxhetit nga drafti i parë në draftin e dytë ngase të heqësh rreth 1 milion euro nga investimet kapitale është punë e mundimshme, e them këtë sepse kemi zvogëluar disa projekte e disa edhe i kemi hequr nga drafti i parë të cilin edhe ju si këshilltarë e keni miratuar në këtë Kuvend, i tërë ky zvogëlim i disa projekteve është bërë mbi bazën e asaj që të ketë një realizim të përgjithshëm. U përmend edhe rruga që lidh fshatrat Penuh – Buricë, rrugë për të cilën

jam në dijeni se është mjaft e rëndësishme që të shtrohet me asfalt ngase kemi qarkullim të nxënësve, por besoj se brenda një kohe shumë të shkurt do të rregullohet njëherë me zhavorr nga shkolla e fshatit Buricë deri në fshatin Penuh, e në një të ardhme të afërt me siguri se do të shtrohet edhe me asfalt. Po ashtu u përmenden edhe trotuaret afër shkollave në rrugë regjionale, për këtë shihet në dokument se janë dy kode, ku njëri është për trotuare afër rrugëve lokale ndërsa kodi tjetër edhe pse është kompetencë e nivelit qendrorë ne i kemi planifikuar buxhet bukur të madh t'i rregullojmë ngase paraqitet rrezik për nxënësit. U përmend edhe fshati Dyz, singërisht e them se në atë fshat është investuar bukur shumë, por projekti i kanalizimit nuk ka mundur të kryhet, por të gjitha projektet të cilat janë përfshirë në rishikim të buxhetit të këtij viti kanë hyrë për vitin e ardhshëm, natyrisht se ka hyrë edhe projekti për ndërtimin e kanalizimit për fshatin Dyz për të cilin kam biseduar edhe me kryetarin e fshatit nga i cili kam kërkuar që të jenë më aktiv edhe banorët e atij fshati, pra mjetet buxhetore në shumë 37,000.00 € janë marrë nga, projektet e kanalizimit në qytet, ndriçimi publik dhe nga projekti i lumit Dumnica, projekte të cilat janë zvogëluar.

z. Haki Rudari, theksoi, në diskutimin tim të mëparshëm kur e thash se nuk është investuar fare që 15 vite në fshatin Dumosh sigurisht se iu referova rrugëve dhe asfaltit. Ne si Grup e kemi vizituar atë fshat dhe jemi të gatshëm kur të dëshironi dhe kush të dëshironi mund të shkojmë të vizitojmë atë fshat dhe ato rrugë gjendja e të cilave është e mjerueshme. U përmend edhe platoja e tregut me një shumë të ndarë rreth 30,000.00 €, jemi dëshmitarë që edhe pas 15 viteve ende qytetarët nuk kanë ku të shesin artikujt e tyre ushqimorë dhe bulmetet e tyre, por shesin buzë rrugëve me pluhur dhe ku kalojnë automjete, gjë për të cilën besoj se nuk është në rregull.

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur tri ditë më parë i kam dhënë sqarimet dhe përgjigjet e nevojshme por meqë në atë takim nuk keni qenë pjesëmarrës të gjithë ju, unë do t'i përsëris vetëm në pika të shkurta disa çështje të cilat u përmenden sot. Shtatë pikat e para apo projektet që janë në vazhdim janë kontrata dy vjeçare. Lidhur me asfaltimin e rrugëve në fshatin Dumosh, ne i kemi përfshirë 7399 m gjatësi rrugë në një kontratë dy vjeçare e cila është nënshkruar dhe është shpallur fituesi legjitim, vlen të theksohet se në ueb faqen zyrtare të KRPP-së mund ti gjeni të gjitha procedurat e tenderimit dhe shpalljet e fituesve. Po ashtu të gjitha projektet tjera pasuese janë projekte voluminoze të cilat kanë nga 2 deri në 7.5 km gjatësi, kështu që ato projekte të cilat në vitin 2014 nuk kemi mundur të përfundojmë për shkak të buxhetit të vogël e të cilat kanë qenë projekte njëvjeçare të gjitha kalojnë në projekte dyvjeçare.

Sa i përket komentit të këshilltarit z. Naim Çunakut i cili e tha se në KPF na është dhënë një arsyetim se janë marrë për bazë vetëm ato projekte të atyre fshatrave apo qytetarëve që kanë hartuar dhe kanë dërguar projekte, kjo nuk qëndron, për arsye se nuk është kriter ashtu siç ai e tha, kurse unë kam thënë se ndër kriteret që ka qenë perceptimi dhe vendosja e projekteve në kornizën afatmesme buxhetore 2015/01 ka qenë edhe ajo, pra arsyeja është shumë e thjeshtë, ne kemi bërë përzgjedhjen në bazë të numrit të banorëve, gjendjes faktike, numrit të nxënësve, strukturës gjinore dhe të moshës së popullatës, dhe ato projekte të cilat kanë qenë të dorëzuara në Drejtorinë e Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit përmes procedurave paraprake të gjitha janë marrë janë analizuar nga stafi i kësaj Drejtorie dhe janë përcaktuar. Çështje tjetër është se me

Udhëzimin Administrativ 01/2014, nuk mund të procedohet më asnjë projekt kapital nëse nuk ka projekt.

z. Nexhmi Rudari, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, në fillim të mbledhjes ishte kërkesa që të bëhet një debat që ka të bëjë me Drejtorinë e Arsimit, me siguri se kjo do të ndodh në seancën e ardhshme ku juve do t'ju dorëzohet një raport në të cilin do të sqarohen të gjitha shqetësimet e juaja të cilat sot u ngritën nga disa këshilltarët parafolës, dhe sqarime tjera të cilat nuk u ngritën këtu, andaj mora fjalën me qëllim që ti jap disa sqarime dhe përgjigje të shkurta për disa pyetje dhe shqetësime të disa këshilltarëve të cilët i shtruan. Sa i përket furnizimit të nxënësve me tekste shkollore, të gjitha shkollat me kohë janë furnizuar me tekste shkollore në bazë të kërkesës për sasinë e nevojshme dhe titujt e nevojshëm, me përjashtim të disa shkollave në fshatra që vetëdija e disa qytetarëve ende nuk është në atë nivel që fëmijët në klasën e parë t'i regjistrojnë sipas afatit ligjor, afat i cili është në muajin maj dhe në atë qershor, pastaj të gjitha ato të dhëna hyjnë në sistemin e menaxhimit të informatave në arsim dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ku në muajin qershor veç e dihet saktë se sa është numri i nxënësve të regjistruar në klasë të parë, kurse në fillim të muajit shtatorë kur procesi mësimorë veç fillon vijnë prindërit dhe i regjistrojnë fëmijët e tyre në klasën e parë dhe që këta emra të atyre fëmijëve nuk figurojnë në databazë të Ministrisë gjë që për këtë arsye tekstet shkollore për ata nxënës janë mungesë. Ne i kemi mbledhur të dhënat në të gjitha fshatrat dhe i kemi evidentuar se ku mungojnë tekstet shkollore në këtë nivel, kemi përsëritë kërkesën në Ministrinë përkatëse dhe jemi në pritje të një përgjigjeje pozitive që edhe për këta nxënës, të vonuar në regjistrim, të sigurohen tekste shkollore.

Sa i përket kërkesës për ndërtimin e shkollës në fshatin Kaçybeg, Ekzekutivi i Komunës në bashkëpunim edhe me Kuvendin e Komunës do të shqyrtojnë këtë mundësi edhe pse mund të kemi disa pengesa ligjore ngase në njërën anë për shkak të buxhetit modest që e kemi na është dashtë që të mbyllim paralele të ndara në disa fshatra për shkak të numrit të vogël të nxënësve, por si do që të jetë ne duhet të analizojmë se a mund të jetë në rritje, a do të jetë ky që është tani apo do të ketë rënie të numri i nxënësve në fshatin Kaçybeg, ngase raporti i nxënësve në klasë është rregulluar me legjislacion bazik ku në viset nën 700 m lartësi mbi detare në një klasë duhet të ketë 21.4 nxënës, pra na mbetet të shohim se a ka mundësi që fshati Kaçybeg t'i ketë mbi 200 nxënës.

Gjithashtu u përmend edhe transporti i nxënësve nga shtëpitë në shkolla dhe anasjelltas, me siguri se jeni në dijeni se edhe viteve të kaluara Drejtoria e Arsimit e Komunës së Podujevës me buxhetin e saj të vogël në kodin e mallrave dhe shërbimeve pothuajse 1/3 e ka shpenzuar për të siguruar transportin përkatës dhe konsideroj se askush nuk është më i interesuar se ne, që këta fëmijë të cilët udhëtojnë, si viseve malore ashtu edhe buzë rrugëve magjistrale me rrezikshmëri të lartë të kenë një transport, mirëpo krejt kjo varet nga buxheti, ne kemi shpallur një tender në të cilin përfshihen edhe meset që u përmenden sot ku një ndër to është edhe fshati Kaçybeg, dhe fatkeqësisht tenderi është përsëritë për shkak të çmimeve shumë të larta që kanë ofertuar operatorët ekonomik përkatësisht 30% deri në 50% më të larta se vitin e kaluar, andaj neve patjetër na është dashur të anulojmë kërkesën dhe të rishpallim tenderin, dhe në tenderin e përsëritur kemi përfshirë vetëm ato mese për të cilat kemi vlerësuar se është jashtëzakonisht e domosdoshme e që fjala është për viset e thella malore ku nxënësit duhet të kalojnë nëpër male dhe kilometra të tëra për të arritur në shkollë. Sa për informatë tuaj nxënësit me nevoja të veçanta në qendrën e cila gjendet në fshatin Gllamnik, prej të gjitha

fshatrave jemi duke i transportuar me një kombibus të Komunës dhe me një shofer të Komunës, krejt kjo bëhet për shkak se çmimi është i përballueshëm duke e ditur faktin që 18.4% e buxhetit nga kategoria mallra dhe shërbime në mënyrë arbitrare është marrë nga Qeveria dhe është bartur në kodin e pagave, prandaj kemi mbetur në mungesë të madhe të buxhetit dhe se këndejmi do të kemi shumë problem të paguajmë lëndët drusore për ngrohje, naftën në ato shkolla të cilat ngrohen me naftë dhe shërbimet tjera për mirëmbajtjen e shkollave. Pati edhe kërkesë për ndërtimin e terrenit sportiv në oborrin e shkollës në fshatin Llugë, shkollë e cila me të vërtetë e ka një sipërfaqe të madhe dhe ka mundësi të ndërtohet një fushë e sportit për nxënës, ne jemi në dijeni se ka pasur një ndërhyrje arbitrare nga jashtë dhe është dëmtuar terreni i asaj shkolle por megjithatë ne në këtë vit kemi bërë një ndërhyrje ku kemi rregulluar dyshtemenë e asaj shkolle ashtu siç kemi bërë ndërhyrje në disa shkolla tjera si, në shkollën e fshatit Katunishtë të cilës është duke iu bërë një mbindërtim me leje, pastaj renovimin total të shkollës së Sekiraqës, shkollë e cila është ndërtuar në vitet e 90-ta me vetë kontribut të komunitetit të atjeshëm, në shkollën e fshatit Lupç të Epërm është bërë një renovim i pjesshëm ashtu sikurse në shkollën e fshatit Dobratin.

Sa i përket trotuareve, siç jeni në dijeni, Drejtoria e Arsimit së bashku me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, vitin e kaluar kemi ndërtuar trotuare pranë shkollave në mese të caktuara ku në disa vende kemi pasur probleme edhe me leje siç është rasti i shkollës në fshatin Shtedim ngase është rrugë në të cilën zhvillohet një shpejtësi më e madhe e veturave se në disa rrugë tjera, mirëpo kemi edhe shkolla të tjera ku së bashku me Drejtorinë e sipërpërmendur planifikojmë të ndërtojmë trotuare edhe afër shkollave të fshatrave, Llugë, Kaçybeg e deri në fshatin Batllavë. Lidhur me transportin e nxënësve të fshatit Penuh të cilët udhëtojnë në shkollën e fshatit Buricë deri në këtë vit ata nxënës kanë shfrytëzuar një rrugë ku kanë kaluar për një pronë private e që distanca nuk ka qenë më e madhe se 500 m deri te shkolla, mirëpo tani ajo pronë është mbyllur nga pronari dhe nuk është e kalueshme më, por si për këta nxënës edhe për të gjithë nxënësit tjerë është Udhëzimi Administrativ me të cilin rregullohet çështja e transportit të nxënësve në shkolla, e që në mënyrë decitive thuhet, *Komuna ka përgjegjësi të siguroj transport falas për të gjithë nxënësit të cilët udhëtojnë nëpër një distancë në njërën anë në një drejtim mbi 4 km*, e që këtë kusht ligjor fatkeqësisht nxënësit e fshatit Kaçybeg nuk e gëzojnë, mirëpo ky do të ishte problemi më i vogël po që se ne të kemi mundësi buxhetore për këtë transport, me siguri se nuk do të merrnim këtë kriter fare për bazë.

z. Bahri Selimi, theksoi, do ti jap disa sqarime rreth çështjes që ka të bëjë me shkollën e fshatit Kaçybeg dhe transportit të nxënësve të këtij fshati, ju njoftoj se në këtë kohë kur ne po debatojmë këtu fshati Kaçybeg numëron gjithsejtë 131 nxënës të cilët vijnë shkollimin në dy fshatra tjera, në shkollën e fshatit Batllavë dhe në shkollën e fshatit Llugë, ndërsa sa i përket kritereve që të ketë 21.4 nxënës për paralele që drejtori parafolës e përmendi, dhe nëse prej këtyre 131 nxënësve afërsisht po them se 100 nxënës mund të jenë deri në klasën e pestë, ngase paraprakisht fshati Kaçybeg ka kërkuar ndërtimin e një shkolle për nxënësit deri në klasën e pestë, po të pjesëtohet me numrin pesë, për pesë paralele na del 20 nxënës, pa i përfshirë edhe disa nxënës të rrethit të cilët mund të kyçen në atë shkollë si dhe pa e përfshirë rritjen shumë të dukshme viteve të fundit të numrit të nxënësve, e që vetëm mua sa më kujtohet në 3 - 4 vitet e fundit kemi rritje shumë të dukshme në këtë raport, kurse në këtë projektbuxhet

nuk është e përfshirë as në tri vitet e ardhshëm ndërtimi i asaj shkolle, pra nëse për tri vitet e kaluara është rritur numri i nxënësve rreth 10% besoj se edhe për tri vitet e ardhshme do të ketë një rritje shumë më të madhe se 10%.

Sa i përket transportit të nxënësve dhe rreth asaj që u përmend për tenderimin, dua të ceku se drejtori i Drejtorisë së Arsimit para disa ditësh e ka dhënë një deklaratë për media në të cilën ka potencuar se procesi i transportit të nxënësve është në ritenderim. Mirëpo sa unë jam në dijeni fshati Kaçybeg nuk është përfshirë në ritenderim fare, do të thotë nuk iu është lejuar të futet fare ky fshat në ritenderim. Ndërsa në Udhëzimin Administrativ i cili u përmend nga parafolësi thuhet se Komuna është e obliguar t'i bartë nxënësit të cilët udhëtojnë mbi 4 km, mirëpo i njëjtë Udhëzim nuk e cek se Komunës i ndalohet transporti i nxënësve të cilët udhëtojnë nën 4 km. kurse sa për njoftim nxënësit e fshatit Kaçybeg udhëtojnë në dy drejtime përreth 7 km, në një rrugë e cila është mjaft e frekuentuar dhe ku zhvillohet një shpejtësi e madhe nga ana e vozitësve të automjeteve të cilët shkojnë në liqenin e Batllavës si vend turistik, si gjatë kohës së verës ashtu edhe në kohën e dimrit.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, u përmend fshati Dyz për të cilin kemi diskutuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, është e vërtetë që pas ridestinitimit të shumës prej 37,000.00 €, prapë janë kthyer ato mjete për ndërtimin e kanalizimit në fshatin Dyz, mendoj se nuk është shumë e madhe kjo që ja vlen të diskutohet shumë ngase Komuna e Podujevës ka një buxhet prej afër 20 milion euro, ndërsa të flitet kaq gjatë për 37,000.00 € mendoj se është e tepërt. Dua ti them drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, që sipas Udhëzimit Administrativ 01/2014 nuk mund të procedohet asnjë investim pa pasur projekt, është shumë e qartë, por nuk bëhet fjalë për projekte që duhet të bëjnë qytetarët, por për projekte të cilat duhet t'i bënë Drejtoria përkatëse e Komunës dhe arkitektët

të cilët mendoj se e kanë edhe detyrë këtë, pra kjo duhet të qartësohet për të gjithë.

Çështja tjetër që ka të bëjë me arsimin në Komunën e Podujevës, duke e falënderuar drejtorin e kësaj Drejtorie i cili e dha një informatë dua t'ja rikujtoj se Komuna numër një në Kosovë me nxënës të cilët nuk e kanë kaluar testin kombëtarë është Komuna jonë, gjë për të cilën mendoj se keni prodhuar analfabet, i nderuar drejtor, ngase këtë e tregon rezultati i cili vjen nga trupi i angazhuar i papërgatitur ku janë larguar profesorët e diplomuar dhe janë pranuar student me nga dy provime të dhëna në fakultet, dhe që shkak i kësaj studentët nga Podujeva e kanë shumë të vështirë të regjistrohen në fakultete, kështu që mendoj se nuk është as disponimi i Kryetarit të Komunës të ketë një drejtor të tillë i cili sidomos këtë vit ka prodhuar një gjeneratë analfabete e cila do të jetë barrë e çdo qeverisje të ardhshme.

z. Nexhmi Rudari, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, për hirë të korrektësisë dua të jap një sqarim ngase parafolësi e përmendi një test dhe nuk jam në dijeni se për cilin test e pati fjalën, për testin e maturës apo për atë të arritshmërisë. Nëse bëhet fjalë për testin e maturës, tri shkollat e Komunës së Podujevës në afatin e parë ka qenë Komuna e dytë në nivel të Kosovës me rezultatin më të mirë, dhe kjo për krejt ata të cilët nuk janë dijeni për këtë mund të vizitojnë ueb faqen e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe aty i gjejnë të gjitha, pra fjala është për afatin e parë ku mesatarja ka qenë mbi 70% dhe janë shifra të cilat nuk mund të ndryshohen, ndërsa sa i përket testit të arritshmërisë, fatkeqësisht nuk është duke u kryer misioni të cilin e ka ky test ngase misioni i këtij testi është që të diagnostifikohet shkolla gjegjësisht sistemi në mënyrë që të jemi në dijeni se

në cilin rang jemi, mirëpo e lus parafolësin që të mos theksoj shifra përmendësh, ngase në realitet është krejt ndryshe dhe se të gjitha të dhënat i posedon Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, janë të dhënat që i posedojmë ne si Drejtori e Arsimit dhe janë të dhënat të cilat i posedojnë shkollat, prandaj edhe njëherë i drejtohem parafolësit që të viziton ueb faqen e Ministrisë përkatëse dhe do të vëren se Komuna e Podujevës është Komuna e dytë me suksesin më të mirë të arritur apo me një përqindje mbi 70%.

z. Naim Çunaku, theksoi, drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit e ceku se nuk ka qenë bazë hartimi i projekteve për të përfshirë në listën e projekteve prioritare për vitin e ardhshëm, në mbledhjen e KPF-së kemi propozuar atë që edhe sot në këtë mbledhje e bëmë, që të parashohim një fond dhe të parashohim mjete buxhetore për hartimin e projekteve, dhe nëse ne nuk e parashohim këtë dhe nëse e kemi të ndaluar të investojmë pa projekte apo nëse nuk mund të realizohet ndonjë investim i caktuar në qoftë se nuk e ka projekt, atëherë shtrohet pyetja, si do të realizohen investimet, a do të bëjmë këtë duke i lutur qytetarët që të hartojnë projekte për t'i futur në listë prioritare ose përndryshe nuk do të ketë projekte. Unë jam shumë i vetëdijshëm që vetë fakti që qytetarët janë pjesë e Komunës ata duhet t'i gëzojnë investimet e Komunës, e them këtë ngase kemi fshatra që për çdo vit buxhetor përmenden për investime ndërsa kemi shumë fshatra që nuk përmenden fare nga 3 apo 4 vite.

Sa i përket asaj që drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit i cili më demantoi rreth asaj që në diskutimin tim e thash se kemi vetëm 13 fshatra të cilat preken nga investimet e kësaj Drejtorie, unë prapë po e përsërisë se decidivisht numërohen 13 fshatra, mirëpo edhe në qoftë se do të jetë dyfishi i këtij numri, prapë nuk do të jetë e kënaqshme kur kemi parasysh 78 fshatra që ka Komuna e Podujevës.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, nënvizoi, qëllimi im nuk është të replikoj me asnjërin prej jush, por fillimisht i falënderoj të gjithë pjesëmarrësit të cilët janë angazhuar në hartimin e projektbuxhetit dhe projekteve prioritare të Komunës së Podujevës për vitet 2015 – 2017, që janë të shumtë duke filluar prej drejtorëve të Drejtorive, Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendit të Komunës, përfaqësuesit e fshatrave dhe qytetarët në përgjithësi.

Konsideroj se vlen të ceket që ky projektbuxhet i është nënshtruar të gjitha procedurave ligjore dhe nënligjore, pa i'u shmangur asnjërës prej tyre. Shfrytëzoj rastin dhe e falënderoj OSBE-në e cila për disa vite me radhë, por edhe këtë vit, me rastin e përgatitjes së projektbuxhetit ka qenë në përkrahje të Komunës së Podujevës gjatë fazave të diskutimeve dhe dëgjimeve buxhetore me qytetarë.

Qytetarët e Komunës së Podujevës i siguroj se në bazë të vlerësimeve që ne i kemi bërë, ky projektbuxhet është gjithëpërfshirës dhe nuk qëndron ajo që u përmend në disa diskutime në këtë mbledhje kinse me këtë projektbuxhet janë prekur vetëm disa fshatra dhe disa lokalitete nga të cilat vijnë zyrtarët e udhëheqësis së Komunës, e tjera e tjera, meqë nëse lexohet me vëmendje ky projektbuxhet, sigurisht do të vërehet se ka projekte të shumta në fshatra dhe lokalitete që nuk ka asnjë zyrtar nga udhëheqësia e Komunës, gjithashtu ka projekte të cilat i përfshijnë disa fshatra, dhe për të mos i'u marrë shumë kohë po e përmendi vetëm projektin për kolektorin e ujërave të zeza përgjatë lumit Dumnica i cili përfshinë disa lokalitete.

Pavarësisht nga këto nuk përjashtohet nevoja për ndonjë korrigjim apo plotësim të këtij propozimi siç është rasti i Zyrës së Vendit në fshatin Lluzhan për të cilën u tha nga disa këshilltarë se nuk është dashur të hiqet nga prioritetet, çështje për të cilën sa unë jam në dijeni nuk është hequr nga prioritetet ndërtimi i Zyrës së Vendit në fshatin Lluzhan, mirëpo jam në dijeni se në atë lokalitet jemi në pritje të një procedure për objektin të cilin kemi menduar ta destinojmë për Zyre të Vendit, duke iu shmangur investimeve shtesë dhe për të mundësuar funksionalizimin sa më të shpejt të asaj Zyreje ngase njëherpërnjëher nuk kemi as lokacion të caktuar për të ndërtuar atë zyrë, por megjithatë konsideroj se fshati Lluzhan si një prej lokaliteteve më të mëdha në Komunën e Podujevës meriton dhe do të të ketë Zyrën e Vendit.

Në këtë dokument mund të ketë ndonjë lëshim eventual, por nuk e besoj fare se janë me qëllime politike ngase edhe po deshëm ne nuk mund t'i ndajmë qytetarët, qoftë në fshatra qoftë në lagje të qytetit në aspektin e përkatësisë së tyre partiake, ngase jemi dëshmitarë se në fshatra dhe lagje të qytetit jetojnë njerëz të cilët kanë bindje të ndryshme politike dhe me asfaltimin e rrugës në lokalitetin përkatës përfitues janë të gjithë, andaj nuk mund të thuhet se kemi investime në baza partiake apo politike ngase këso dallimesh nuk kemi bërë asnjëherë dhe nuk do të bëjmë as në të ardhmen.

Kështu që edhe njëherë i falënderoj të gjithë ata të cilët kanë kontribuar në këtë proces, dhe ju ftoj juve, në cilësinë e këshilltarëve të Kuvendit që ta votoni këtë propozim në mënyrë që të na mundësohet ta procedojmë më tutje.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pasi më nuk të lajmëruar për debat, unë e hedh në votim propozim vendimin përkatës së bashku me rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe Rregulloren e Tatimit në Pronë për vitin 2015, si pjesë përbërëse e këtij propozimi.

Pas votimit u konstatua se me 19 vota për, 15 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua propozimi i vendimit për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës dhe projektet prioritare për vitet 2015 – 2017, dhe njëkohësisht si pjesë përbërëse e këtij vendimi miratohet edhe Propozimi i Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2015

4. Propozimi i vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, jeni në dijeni se ky propozim ka qenë pikë e rendit të ditës edhe në mbledhjen e kaluar mirëpo pasi që është lëshuar mbledhja nga disa Grupe të këshilltarëve dhe nga disa këshilltar, nuk kemi pasur kuorum për të vazhduar mbledhjen dhe për të formuar këtë komision.

Ju informoj se duke u bazuar në procedurat për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Asociacioni i Komunave të Kosovës në bashkëpunim me kolegjiun e zyrtarëve ligjor të Komunave ka hartuar një komentare në të cilin thuhet, Kuvendi i Komunës me vendim formon komisionin për shqyrtimin e ankesave, me përbërje prej pesë anëtarëve, dhe atë, dy anëtarë nga Kuvendi i Komunës, dy anëtarë nga Ekzekutivi i Komunës dhe një anëtar nga Shoqëria Civile i propozuar nga Kryetari i Komunës. Në mbledhjen e kaluar nga Ekzekutivi i Komunës janë propozuar dy drejtor të

Drejtorive, përkatësisht, z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe z. Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, si dhe nga Shoqëria Civile është propozuar z. Bejtush Dushi. Andaj për të formuar këtë komision na mbeten edhe dy anëtarë nga Kuvendi e që propozimin e parë e bënë subjekti politik më i madh në Kuvend që është LDK, pastaj një propozim tjetër nga subjekti i dytë më i madh i përfaqësuar në Kuvend.

z. Fidan Rekalu, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, për anëtarë të këtij komisioni e propozojë z. Fatlume Jaha.

z. Naim Çunaku, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, për anëtarë të këtij komisioni e mban propozimin e bërë në mbledhjen e kaluar gjegjësisht propozon z. Rafet Llapashtica.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, tani kemi pesë anëtarë të propozuar për këtë komision, dhe mund të hedhim në votim, mirëpo para se të votohet, fjalën e ka kërkuar përfaqësuesi i Lëvizjes Vetëvendosje.

z. Haki Rudari, theksoi, paraprakisht dua të ndërlihem me votimin e pikës paraprake ku u votua Rregullorja e tatimit në pronë pa pasur debat fare dhe mendoj se është fillimi i një ngufatjeje të demokracisë apo debatit, e them këtë ngase mendoj se pavarësisht a kolon apo nuk kalon duhet të ketë debat, do të thotë se u miratua diçka për të cilën nuk u lejua debati gjë që nuk është në rregull.

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, ne kemi thënë edhe në mbledhjen e kaluar se dy anëtarë kemi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës e që realisht janë nga LDK-ja, si dhe propozimi i anëtarit nga Shoqëria Civile po ashtu, ndërsa kur vie në shprehje propozimi për përfaqësuesin nga Lëvizja Vetëvendosje nuk e di pse stagnohet dhe se nuk jam në dijeni kujt i pengon që në këtë komision të përfaqësohet edhe LVV-ja.

Prandaj ne si Grup kërkojmë që edhe Lëvizja Vetëvendosje të përfaqësohet në komisionin përkatës, dhe propozojmë z. Adelinë Stublla.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me propozimin e parafolësit mendoj se duhet të hedhet në votim, mirëpo për të votuar këtë duhet të hiqet një tjetër propozim ngase e sqaruam më parë se komisioni duhet të përbëhet prej pesë anëtarëve por meqë pati propozim nga parafolësi unë e hedhë në votim atë.

Kështu që hedh në votim këtë propozim të bërë nga z. Haki Rudari.

z. Naim Çunaku, theksoi, konsideroj se forma e udhëheqjes së mbledhjes nuk është në rregull, ngase nga të gjitha Grupet e këshilltarëve të Kuvendit pati propozime për anëtarë të këtij komisioni, andaj konsideroj se nuk mund të hedhet në votim secili propozim veç e veç por duhet të hedhet në votim për tri propozimet njëkohësisht, përkatësisht me një votim të votohet për z. Fatlume Jaha, z. Rafet Llapashtica dhe z. Adelinë Stublla, pra të mos vazhdohet me këtë formë.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, andaj përveç dy propozimeve nga Ekzekutivi i Komunës dhe një propozimi nga Kryetari i Komunës, tani i hedh në votim me radhë secilin propozim të bërë nga Grupet e këshilltarëve, kështu që së pari votojmë për propozimin që z. Fatlume Jaha të jetë anëtarë në përbërje të komisionit përkatës.

Pas votimit u konstatua se me shumicë të votave përkatësisht me 19 votë për, miratohet propozimi i Grupit të Këshilltarëve nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, që në përbërjen e këtij komisioni të jetë z. Fatlume Jaha.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në radhë është propozimi i bërë nga përfaqësuesi i subjektit politikë PDK z. Naim Çunaku i cili propozoi z. Rafet Llapashticën.

Pas votimit u konstatua se me 13 vota për, asnjë votë kundër dhe asnjë votë të përmbajtur nuk u miratua propozimi i Grupi të këshilltarëve nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës që në përbërje të këtij komisioni të jetë z. Rafet Llapashtica.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, meqë kemi tri propozime konsideroj se do të ishte mirë që procedura e votimit t'ju nënshtrohet votave të fshehta, ngase kemi tri propozime dhe ne mundemi të votojmë edhe për propozimin e parë edhe për të dytin por edhe për të tretin.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, është e drejtë e Kuvendit për mënyrën e votimit, mirëpo ne në fillim të kësaj procedure filluam të votojmë me votim të haptë duke hedh në votim secilin propozim veç e veç, pas votimit paraprak u konstatua se nuk kaloj propozimi i PDK-së që z. Rafet Llapashtica të jetë në përbërje të këtij komisioni ngase vetëm 13 këshilltarë votuan për ndërsa të tjerët nuk votuan. Tani në votim e hedh propozimin e grupit të këshilltarëve të LVV-së.

Pas votimit u konstatua se me 22 vota për, asnjë votë kundër dhe asnjë votë të përmbajtur miratohet propozimi i Grupit të këshilltarëve nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje që në përbërje të këtij komisioni të jetë z. Adelinë Stublla.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se ngritët komisioni për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim, në këtë përbërje:

- | | |
|-----------------------|------------------------------------|
| 1. z. Avni Fetahu, | anëtar nga Ekzekutivi i Komunës |
| 2. z. Agron Hyseni, | anëtar nga Ekzekutivi i Komunës |
| 3. z. Fatlume Jaha, | anëtare nga Kuvendi i Komunës |
| 4. z. Adelinë Stublla | anëtare nga Kuvendi i Komunës, dhe |
| 5. z. Bejtush Dushi, | anëtar nga Shoqëria Civile |

Lëshohet mbledhja nga radhët e Grupit të këshilltarëve të Partisë Demokratike të Kosovës dhe këshilltarit nga subjekti Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

z. Bahri Selimi, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të Lëvizjes Vetëvendosje jemi në pozitë të pakënaqshme dhe nuk jemi duke e parë një frymë të mirë të punës, andaj vendosëm që mos të marrim pjesë më në vazhdimin e kësaj mbledhjeje.

Pas thirrjes së emrave të këshilltarëve të Kuvendit, konstatohet se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje, përkatësisht në nga 35 këshilltarë sa janë gjithsejtë, prezent në sall janë 19 këshilltarë të Kuvendit.

5. Propozimi për lejimin e inicimit të procedurës për këmbimin e pronës komunale në emër të SHFMU “Kadri Kadriu” me pronë private

z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, e paraqiti fjalën hyrëse për këtë pikë të rendit të ditës.

Pas votimit u konstatua se njëzëri, përkatësisht me 19 vota për, asnjë votë kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua ky propozim vendim

6. Propozimi i vendimeve për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (sipas kërkesave të Salih Tullarit nga fshati Tërnavë, dhe Naip Plakolli nga fshati Letanc)

Pas votimit u konstatua se njëzëri, përkatësisht me 19 vota për, asnjë votë kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratuan këto dy propozim vendime, përkatësisht:

Propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (sipas kërkesës së Salih Tullarit nga fshati Tërnavë), dhe

Propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (sipas kërkesës së Naip Plakollit nga fshati Letanc)

7. Të Ndryshme

Nuk pati diskutime

Mbledhja përfundoi në orën 12:10

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-85032
Podujevë,
29 shtator 2014**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**